



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 18/07/2022 Ref.: 942/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 101-të, të mbajtur më 30.06.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Riakreditohen** programet e studimit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (USHAF), për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2027:
  1. *Arkitektura e Gjelbër dhe Dizajni i Interierit, MSc 120 ECTS*, maksimumi 40 studentë për vit akademik;
  2. *Inxhineria dhe Menaxhimi i Prodhimit, MSc 120 ECTS*, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
  3. *Dizajn Grafik dhe Multimedia, Bachelor Profesional, 180 ECTS*, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
- II. **Riakreditohen** programet e studimit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025:
  1. *Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia, BSc 180 ECTS*, maksimumi 150 studentë për vit akademik;
  2. *Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm, MSc 120 ECTS*, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
- III. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj që çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportojë dhe arsyetojë në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë;

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Arkitektura e Gjellbër dhe Dizajni i Interierit, MSc</i> 120 ECTS Ri akreditim	Agron Bajraktari Bashkim Thaçi
2.	<i>Inxhineria dhe Menaxhimi i Prodhimit, MSc</i> 120 ECTS Ri akreditim	Bujar Pira Sejdi Hoxha
3	<i>Dizajn Grafik dhe Multimedia, Bachelor Profesional, 180 ECTS</i> Ri akreditim	Florit Hoxha Lejla Ibrahim Faton Spahiu
4	<i>Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia, BSc</i> 180 ECTS	Aziz Rexhepi Bislim Lekiqi Sokol Krasniqi Ismajl Mehmeti
5	<i>Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm, MSc</i> 120 ECTS	Alberta Tahiri Afrim Loku


Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj me këtë përbërje: Olgun Cicek, Rebecca Maxwell, Tauno Otto, Mikus Dubickis, Diana Milcic dhe Lina Nunes. Vizitat janë organizuar në datat 04.04.2022 dhe 26.05.2022.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit dhe për secilin program, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Arkitektura e Gjellbër dhe Dizajni i Interierit, MSc* 120 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: katër (4) standarde plotësisht dhe tre (3) standarde substancialisht.
2. Për programin e studimit *Inxhineria dhe Menaxhimi i Prodhimit, MSc* 120 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht gjashtë (6) standarde dhe substancialisht një (1) standarde.
3. Për programin e studimit *Dizajn Grafik dhe Multimedia, Bachelor Profesional, 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1) standarde dhe substancialisht pesë (5) dhe pjesërisht një (1) standarde.
4. Për programin e studimit *Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia, BSc* 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht katër (4) standarde dhe pjesërisht tre (3) standarde.
5. Për programin e studimit *Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm, MSc* 120 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5) dhe pjesërisht dy (2) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 101 të mbajtur më 30.06.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatim prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

  
Prof. Ass. Dr. M. Haxhi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të



Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.